Tiranë/ Turku plagosi me armë zjarri bashkatdhetarin në Sauk, policia zbardh dinamikën e ngjarjes! I lënduari pretendon se nuk e njeh autorin

Sipas dyshimeve paraprake, mes dy turqve ka pasur edhe një përplasje disa ditë më parë, ndërsa dje ata dyshohet se kishin lënë takim në një lokal për t'u soqaruar në zonën e Saukut.

■ Report Tv siguron foton kur turku largohet me vrap pas plagosjes së 36-vjeçarit

Foto ilustruese

Sokol Dema
10 Mars, 09:16 | **Përditesimi: 10 Mars, 17:51**

Share Post

Tiranë- Një konflikt që dyshohet se ka nisur në Turqi mendohet të jetë shkaku i ***plagosjes*** së mbrëmjes të së hënës në zonën e Saukut, ku mbeti i lënduar turku Halil Uçar. Gjatë marrjes në pyetje nga grupi hetimor, i lënduari, 36-vjeç ka deklaruar se nuk e njeh autorin e ngjarjes (gjithashtu turk), dhe se nuk ka asnjë konflikt me të.

Ndërkohë Policia ka zbardhur të plotë dinamikën e plagosjes. Sipas bluve autori dhe i plagosuri kanë qenë në tavolina të ndara dhe në kate të ndryshme. Autori, i paidentifikuar, pasi ka konsumuar darkën në katin e parë, është ngjitur në kat të dytë dhe ka qëlluar drejt Uçar, duke e plagosur me një plumb në shpatull.

Pas ngjarjes është ai arratisur me shpejtësi nga zona. Policia ka mundur të sigurojë disa foto përmes kameravë të sigurisë dhe po punon me Interpolin jo vetëm për identifikimin, por edhe problemet që mund të kenë pasur. Në vendndjarje dhe te tavolina ku ka konsumuar darkën janë marrë materiale gjenetike të plota për identifikimin.

Paraprakisht Policia nuk përjashton mundësinë e ndonjë hakmarrjeje të mundshme për konflikte të tyre në Turqi.

Gjatë incidentit, i plagosuri u qëllua me një plumb në shpatull, por fatmirësisht ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Autori, dyshohet se ka tentuar disa herë të qëllojë ndaj shënjestrës, por vetëm një plumb është shkrepur, pasi pistoleta i është bllokuar.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 17:39

Plagosi bashkëatdhetarin e tij me armë zjarri në Sauk, del FOTOJA e turkut të shpallur në kërkim në Shqipëri

Report Tv ka siguruar foton e turkut të shpallur në kërkim nga policia pasi plagosi me armë zjarri një bashkëatdhetarin e tij, mbrëmjen e djeshme, në zonën e Saukut, në Tiranë. Ende nuk dihet emri i autorit turk, i cili plagosi bashkëatdhetarin e tij Halil Uçar, për shkaqe që dyshohet të kenë nisur në Turqi.

K.M/Shqiptarja.com

Share

Ora 12:34

Plagosi me armë zjarri bashkatdhetarin në Sauk, Report Tv siguron foton kur turku largohet me vrap!

Report Tv ka siguruar foton e turkut që plagosi bashkatdhetarin e tij në natë më parë në zonën e Saukut. Policia po punon për identifikimin e tij.

Sipas hetimeve paraprake nuk përjashtohet mundësia e ndonjë hakmarrjeje të mundshme për konflikte të tyre në Turqi.

Xh.K/Shqiptarja.com

Share

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Tirane sauk plagosje me arme zjarri

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
PS nuk jep aprovimin për arrestimin e Ballukut, si e vlerësoni?
9 Mars, 15:01
Të drejtë | Të gabuar | Jam i/e dyzuar

Lajme të tjera

Dita e Verës në Tiranë, devijohet trafiku për 2 ditë! Si do të jetë kufizimi i qarkullimit dhe lëvizja e mjeteve më 14 mars

11 Mars, 11:55

Sallë multifunksionale, hapësira për fëmijët me aftësi ndryshe... 'Pjetër Budi' do të hapet për vitin e ri shkollor

11 Mars, 11:12

Konsumoi fostoksinë, 25-vjeçarja nga Lezha ndërron jetë në QSUT! Familjarët kallëzim: U dhunua nga partneri! Në kërkim i riu

Sokol Dema

11 Mars, 10:57

Rreth 3500 vendime legalizimi ende të patërhequra në Tiranë dhe Kamëz! Kadastra publikon emrat e përfituesve

11 Mars, 08:41

Operacion kundër lojërave të paligjshme të fatit në Tiranë, Policia 'bastis' 2 lokale, arrestohen 3 persona

10 Mars, 16:10

Pas zërave për zaptim të hapësirës publike në Komunën e Parisit, reagon Braçe: Ju gënjejnë, zero leje nga ana ime!

10 Mars, 15:46

I dënuar në Itali me 8 vite e 11 muaj burg për vjedhje dhe plagosje, 32-vjeçari arrestohet në Tiranë me qëllim ekstradimin (EMRI)

10 Mars, 14:32

Mbi 13 mijë gra në Shqipëri gjetën punë në vitin 2025, mijëra të tjera në kurse dhe biznese të reja

10 Mars, 12:41

Plagosi me armë zjarri bashkatdhetarin në Sauk, Report Tv siguron foton kur turku largohet me vrap!

10 Mars, 12:34

Kupa e Shqipërisë/ Hidhet shorti për fazën gjysmëfinale, Dinamo 'peshkon' Vllazninë! Egnatia luan kundër AF Elbasanit

10 Mars, 10:17

Trafik armësh nga Mali i Zi me destinacion 'Freskun', momenti kur policia shtrin në tokë dhe prangos 2 të rinjtë, sekuestrohen 6 pistoleta (EMRAT+VIDEO)

Tiranë/ Tritol një automjeti të parkuar, pronari me precedent penal, shkak dyshohet aktiviteti i 36-vjeçarit në Spanjë (EMRI-FOTO)

10 Mars, 08:46

Lajmi i fundit

BE-ja vendos sanksione ndaj 19-të zyrtarëve iranianë

11 Mars, 13:11